



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA Durrës**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDIM**

Nr. 9, datë 10.02.2026

**PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË VKB NR. 66, DATË 11.11.2025 “PËR MIRATIMIN E UDHËZUESIT PËR MËNYRËN E APLIKIMIT “PËR IMPLEMENTIMIN E SKEMËS: GRANTE PËR TË RINJTË NË MBËSHTETJE TË ZHVILLIMIT TË INICIATIVAVE EKONOMIKE LOKALE””**

Në zbatim të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr. 9374, datë 21.04.2005 “Për ndihmën shtetërore” i ndryshuar, ligjit nr. 36/2023 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 25/2022, “Për mbështetjen dhe Zhvillimin e Startup-eve”, ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.605, datë 31.08.2016 “Për përcaktimin e vlerës maksimale, të kushteve dhe të procedurës për dhënien e ndihmës “de minimis”, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 73, datë 23.12.2026 “Për miratimin buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2026 dhe Programin Buxhetor Afatmesëm 2026-2028”, shkresës së Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Drejtorisë së Përgjithshme të Nxitjes së Biznesit nr.7875 prot., datë 12.06.2025, protokolluar me tonën nr. 1975/2 prot., datë 16.06.2025 si dhe sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Turizmit, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

**KËSHILLI BASHKIAK**  
**V E N D O S I :**

1. Ndryshimin e Udhëzuesit për mënyrën e aplikimit “Për implementimin e skemës: Grante për të rinjtë në mbështetje të zhvillimit të iniciativave ekonomike lokale” miratuar me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 66, datë 11.11.2025 “Për Miratimin e Udhëzuesit për Mënyrën e

Aplikimit “Për Implementimin e Skemës: Grante për të Rinjtë në Mbështetje të Zhvillimit të Inicativave Ekonomike Lokale”, si më poshtë vijon:

- A. Pika 1, **Hyrje**, paragrafi tre i Udhëzuesit për Mënyrën e Aplikimit “Për Implementimin e Skemës: Grante për të Rinjtë në Mbështetje të Zhvillimit të Inicativave Ekonomike Lokale” ndryshon si më poshtë vijon:

“Përmes kësaj thirrjeje, synohet të mbështeten të rinjtë, artizanë, organizatat e shoqërisë civile, të cilët kanë ide për krijim e bizneseve të reja ose zgjerimin e atyre ekzistuese,— të cilët mund të japin një kontribut konkret në:

- nxitja e turizmit të qëndrueshëm nëpërmjet investimeve...”

- B. Pika 4.1 “**Të rinj individë dhe Organizata të shoqërisë Civile**” e udhëzuesit të sipërcituar ndryshon si më poshtë vijon:

“Individë që kanë një ide biznesi ose një projekt të lidhur me:

- artizanatin tradicional,
- prodhimin lokal me vlerë kulturore,
- turizmin kulturor apo ekoturizmin,
- produktet bio dhe bujqësinë e qëndrueshme në zonat rurale
- teknologji të gjelbra apo menaxhim të mbetjeve”.

- C. Pika 1 e Udhëzuesit të Aplikimit “**Çfarë është granti për “Bizneset në sektorin e mjedisit dhe trashëgimisë kulturore**”, ndryshon si më poshtë vijon:

Biznese ekzistuese të vogla dhe të mesme (SME)

Subjekte të regjistruara që kërkojnë të:

- zgjerojnë aktivitetin e tyre,
- rrisin cilësinë e produkteve/shërbimeve sipas objektivave prioritare të thirrjes,
- investojnë në teknologji të pastër ose qëndrueshmëri,
- kalojnë në forma më të formalizuara të operimit”.

- D. Pika 2 e Udhëzuesit të Aplikimit “**Mbështetja financiare**”, ndryshon si më poshtë vijon:

Fondi total i Skemës së granteve 4.000.000 lekë dhe financohet plotësisht nga Bashkia Durrës.

Granti për aplikim: Aplikimet që plotësojnë kriteret e kësaj skeme janë ato që kërkojnë një buxhet deri në 1 000 000 leke për projekt propozim. Komisioni ka të drejtë të bëjë rishikimet përkatëse të buxhetit, kur shikohet e nevojshme.

Granti do të mbështesë të rinjtë e moshës 18-30 vjeç, banues në Bashkinë Durrës, të cilët kanë një ide për krijimin e një biznesi të ri apo që kanë biznes ekzistues të vogël apo të mesëm dhe kërkojnë të kontribuojnë në sektorin e mjedisit dhe të trashëgimisë kulturore, për një projekt propozim me afat 6-12 muaj dhe shuma do të shpërndahet në bazë të planit financiar të aplikimeve fituese.

- Skema e grantit mbulon 100% të shpenzimeve të pranueshme brenda limitit të sipërpërmendur

- Bashkëfinancimi është i detyrueshëm
- Grantet e alokuara në këte thirrje mund të mbulojnë shpenzimet e personelit deri në masën 20% të shumës së kërkuar, pjesa tjetër prej 70% e fondit duhet të parashikohet për aktivitetet e projektit dhe 10% e fondit duhet të përdoret për dukshmëri dhe promovim
- Granti nuk jepet më shumë se një herë për të njëjtën sipërmarrje, brenda 2 viteve.
- Efektet financiare për zbatimin e këtij aktiviteti do të përballohen nga buxheti i miratuar i Bashkisë Durrës.
- Bashkia ka të drejtë për të mos i ndarë të gjitha fondet në dispozicion nëse projekt-propozimet nuk i përmbushin kriteret e kërkuara.
- Aplikantët e përzgjedhur mund të planifikojnë financim tjetër shtesë (jo i detyruar) duke përdorur instrumente financiare ( Kredi, Hua, Grante) të disponueshme në Shqipëri, nëpërmjet institucioneve financiare ose projekteve të financuara nga donatorë të tjerë ose financat e tyre. Në të gjitha rastet e mesiperme financimi shtesë duhet të deklarohet bashkë me burimin e financimit. Financimi shtesë duhet të përdoret së bashku me asistencën e grantit për fillimin e planit të biznesit, prandaj burimi i financimit duhet të përfshihet në planin e biznesit dhe do të jetë subjekt i vlerësimit.
- Nëse instrumenti financiar do të përdoret për zgjerimin e mëtejshëm të biznesit kjo mbështetje shtesë e përfituar pritet që të raportohet në vizitat dhe raportet e monitorimit.
- Shpenzimet e parakryera nuk do të njihen si investim, por vetëm shpenzimet pas nënshkrimit të kontratës së grantit janë të vlefshme.
- Përfituesit e fondeve nuk janë të autorizuar për kalimin tek palë të treta . Të gjitha detajet specifike mbi kohën dhe pagesat do të përcaktohen në marrëveshjen kontraktuale të grantit në përputhje me projektin dhe specifikat e tij”.

**E. Pika 5.2 e Udhëzuesit të Aplikimit “Shpenzimet që mund të mbulohen nga skema” ndryshon si më poshtë vijon:**

Shpenzimet që nuk mund të mbulohen nga granti përfshijnë:

- Shpenzimet e lindura, krijuara përpara nënshkrimit të kontratës së grantit
- Mirëmbajtje dhe riparime
- Vlera e qerasë së ambjentit para dhe mbas përfundimit të projektit
- Blerje e pasurive të patundshme
- Blerjen e mjeteve të transportit
- Cdo shpenzim që nuk lidhet me biznesin e propozuar
- Zbavitje dhe dhurata
- Dieta dhe udhëtime”

**F. Pika 8.1 e Udhëzuesit të Aplikimit “Komisioni i vlerësimit”, ndryshon si më poshtë vijon:**  
Komisioni i vlerësimit të aplikimeve është organ i krijuar nga Bashkia Durrës i cili realizon vlerësimin e aplikimeve të dorëzuara në përputhje me kriteret e përcaktuara në skemën e grantit. Puna e komisionit do të jetë në përputhje me rregullat e skemës së grantit dhe

kriteret e përcaktuara qartë për vlerësimin e aplikimeve. Ky komision do të ngrihet me urdhër të Kryetarit të Bashkisë Durrës. Përbërja e Komisionit të Vlerësimit do të ndryshohet në rastet kur do të ri-shpallet thirrja publike për grante për të rinjtë. Takimet e komisionit do të organizohen pranë ambienteve të Bashkisë Durrës. Anëtarët e Komisionit do të vlerësojnë secilin aplikim për ide biznesi në mënyrë të pavarur bazuar në kriteret e përcaktuara.

**G. Pika 8.2 e Udhëzuesit të Aplikimit “Koordinatori i skemës së Grantit”, ndryshon si më poshtë vijon:**

Përfaqësues nga Drejtoria e Turizmit do të shërbejë si koordinator të skemës dhe do të jenë përgjegjës të menaxhimit operacional të saj deri në momentin e lidhjes së kontratës me përfituesit. Koordinatorët janë përgjegjës për zbatimin në kohë të të gjitha aktiviteteve të skemës deri në momentin e lidhjes së kontratës me përfituesit. Gjithashtu, organizojnë takimet e komisionit të vlerësimit, sigurojnë shpërndarjen e dokumentacionit tek ata, si dhe mbledhin firmat nga të gjithë anëtarët e komisionit. Koordinatorët janë përgjegjës për menaxhimin e të gjitha dokumentave deri në momentin e lidhjes së kontratës me përfituesit dhe ruajtjen e tyre në Drejtorinë e Turizmit. Koordinatorët e Skemës së grantit do të caktohet me urdhër të Kryetarit të Bashkisë Durrës.

**H. Pika 9.1 e Udhëzuesit të Grantit “Shpallja e thirrjes së grantit”, ndryshon si më poshtë vijon:**

Thirrjet për shprehjen e intreresit do të shpallen në faqen zyrtare të internetit të Bashkisë Durrës dhe në media sociale. Thirrja do të qëndrojë e hapur jo më pak se 4 javë nga dita e shpalljes.

Një njoftim publik (Aneksi 1) do të hartohet nga koordinatorët e skemës. Njoftimi duhet të përfshijë informacionin për tërësinë e procesit të aplikimit dhe kriteret e pranueshmërisë. Ai duhet të përfshijë gjithashtu informacion për cdo takim informues që do të organizohet gjatë kohëzgjatjes së thirrjes. Njoftimi duhet të publikohet në faqen e internetit të Bashkisë Durrës dhe media sociale.

Shpallja e skemës së grantit do të publikohet në faqen zyrtare të Bashkisë Durrës dhe do të përmbajë:

- Formularin e aplikimit për grantin (Aneksi 6)
- Planin e biznesit dhe të financimit sipas modelit të kërkuar (certifikime, patenta të tjera dokumenta suportuese) (Aneksi 7)

Dokumentat shtesë duhet të përmbajnë:

- Formularin e vetëdeklarimit (Aneksi 16)
- Kopjen e kartës së identitetit
- Kopjen e ekstraktit të biznesit nga regjistri tregtar të lëshuar nga QKB për bizneset ekzistuese (nga e-albania)
- Të gjithë aplikantët që synojnë të hapin një biznes të ri kanë afat 15 ditë pas aprovimit të grantit dhe firmosjes së kontratës për rregjistrimin e bizneseve të tyre pranë zyrave të QKB

- Vërtetimi origjinal për llogari bankare në lekë për bizneset ekzistuese. Bizneset e reja do të sjellin llogarinë bankare pasi pasi të jenë shpallur fitues dhe të jenë rregjistruar në QKB.

Të gjithë aplikantët duhet ti qendrojnë në mënyrë rigoroze formatit të aplikimit dhe formave të bashkëngjitura në këtë udhëzim.

**I. Pika 9.2, paragrafi i parë dhe i dytë, të Udhëzuesit të Aplikimit “Vlerësimi dhe përzgjedhja e aplikimeve”, ndryshon si më poshtë vijon:**

Shqyrtimi dhe vlerësimi i Aplikimeve do të kryhet nga Komisioni i Vlerësimit. Takimet e vlerësimeve do të organizohet nga Koordinatorët e skemës. Aplikimet do të shqyrtohen dhe vlerësohen nga Komisioni i Vlerësimit, i cili do të përbëhet nga 5 anëtarë, nga të cilët 3 janë përfaqësues të Bashkisë Durrës, një përfaqësues i Universitetit “Aleksandër Moisiu” dhe një përfaqësues nga organizata ndërkombëtare “World Vision”. Përbërja e Komisionit të Vlerësimit do të ndryshohet në rastet kur do të ri-shpallet thirrja publike për grante për të rinjtë.

Procesi për vlerësim administrativ dhe përzgjedhja e kandidatëve duhet të fillojnë jo më vonë se pesë ditë pune pas afatit përfundimtar për dorëzimin e aplikimeve. Të gjithë anëtarët e Komisionit duhet të jenë të panishëm në takim. Procesi nuk duhet të zgjasë më shumë se 7 (shtatë) ditë pune.

**J. Pika 9.6, paragrafi i parë i Udhëzuesit të Aplikimit “Ankesat” ndryshon si më poshtë vijon:**

Pas botimit zyrtar të rezultateve, aplikuesit kanë të drejtë të ankimojnë rezultatin brenda pesë ditësh pune nga marrja e njoftimit. Të gjitha ankimimet e paraqitura brenda afatit përfundimtar shqyrtohen nga Komisioni i Vlerësimit, që duhet të informojë aplikantin për vendimin dhe përfundimet e tyre me shkrim brenda pesë ditësh pune....

**K. Ankesi 3 – Formulari i Aplikimit ndryshon si më poshtë vijon:**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DURRËS

**Aneksi 3 – Formulari i Aplikimit**

• **Informacione kontakti**

|                                |  |
|--------------------------------|--|
| Emri dhe Mbiemri i Aplikantit: |  |
| Adresa:                        |  |

|                                     |  |
|-------------------------------------|--|
| Numri i telefonit:                  |  |
| E-mail:                             |  |
| Numri i Kartës së Identitetit:      |  |
| Niveli i arsimit, fusha e arsimit * |  |
| Aftësi të tjera *                   |  |
| Profesioni *                        |  |

**\*Opsionale**

- **Biznesi im është** (klikoni njëren prej kutive):

☐ Individ (i pargjistruar)                      ☐ Biznes ekzistues (i regjistruar)

- **NIPT-i i biznesit**, (nëse e aplikueshme):

- .....
- **Spektori i biznesit**, (klikoni njëren prej kutive):

☐ Mjedis                      ☐ Trashëgimi Kulturor                      ☐ Turizëm

- **Titulli i projektit**, (Shkruani një titull të shkurtër për aplikimin):

- .....
- **Kohëzgjatja e projektit**, tregoni numrin e muajve që nevojiten për realizimin (maksimumi deri në 6 - 12 muaj). Sa kohë keni që punoni me idenë/biznesin dhe sa keni avancuar në implementimin e projekt-idesë tuaj?

- .....
- **Shuma e financimit që kërkoni nga granti** (e shprehur në lekë):

- .....
- **Jepni një përshkrim të shkurtër të idesë tuaj të biznesit:**

- .....
- **Biznesi im do të ofrojë produktet/shërbimet e mëposhtme:**

- .....
- **Do të shes produktet/shërbimet e mia në** (përshkruani tregun tuaj):
- .....

- Konkurrenca ekzistuese dhe avantazhi konkurrues i biznesit tim:

- Aftësitë, përvojat dhe njohuritë që zotëroj për të zhvilluar këtë biznes:

- Zgjedha këtë ide biznesi sepse:

*\*Ju lutemi bashkangjisni edhe dokumente shtesë që vërtetojnë arsimin, aftësitë dhe eksperiencat e sipërpërmendura.*

Unë i/e nënshkruara ..... me nr. ID .....banuese ne Durrës, adresa; .....deklaroj se të dhënat që përmban ky aplikim janë dhënë me vullnetin time të lirë, në përputhje me mbrojtjen e të dhënave personale, të garantuar nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe në përputhje me Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i cili garanton konfidencialitetin e të dhënave të klientit dhe në këtë mënyrë jap shprehimisht pëlqimin tim që ato të përdoren nga Bashkia e Durrësit për qëllime të kryerjes së aktivitete të saj.

Nënshkroi:

Data:

- L. Aneksit 7 "Formular për Plan Biznesi", pika 6.4 "Burimet e financimit" ndryshon si më poshtë vijon:

#### 6.4 Burimet e financimit

Bashkëfinancimi apo kontributi i vetë biznesit është i detyrueshëm dhe duhet të jetë minimumi në vlerën 20% të vlerës totale të propozimit dhe mund të jetë nga burime alternative ose financime të tjera nga institucione financiare, por mund të shprehet me kontribut në natyrë (in-kind), që mund të jenë paga, vlerë qiraje ambienti (për bizneset ekzistuese), vlerë pajisjesh ekzistuese etj.

| Nr. | Përshkrimi i financimit                        | TOTALI NË LEKË |
|-----|------------------------------------------------|----------------|
| 1   | Financim nga Granti                            |                |
| 2   | Kontributi i vetë Biznesit                     |                |
| 3   | Burime të tjera financiare (nëse ka)           |                |
|     | <b>TOTALI I BURIMEVE TË FINANCIMIT NË LEKË</b> |                |

- M. Aneksit 7, "Formular për Plan Biznesi", Tabela 3, ndryshon si më poshtë vijon:

**Tabela 3. PARASHIKIMET E LIKUIDITETIT**

|          | MUAJT                                          | 1 | 2 | 2 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | Totali |
|----------|------------------------------------------------|---|---|---|---|---|---|---|---|---|--------|
| <b>A</b> | <b>GJENDJA NE FILLIM</b>                       |   |   |   |   |   |   |   |   |   |        |
| <b>B</b> | <b>HYRJET NE PARA (1-5)</b>                    |   |   |   |   |   |   |   |   |   |        |
| 1        | Të ardhurat nga shitja e produkteve            |   |   |   |   |   |   |   |   |   |        |
| 2        | Hyrje nga debitorët                            |   |   |   |   |   |   |   |   |   |        |
| 3        | Kreditë bankare                                |   |   |   |   |   |   |   |   |   |        |
| 4        | Kapitali i pronarit                            |   |   |   |   |   |   |   |   |   |        |
| 5        | Të ardhura nga granti                          |   |   |   |   |   |   |   |   |   |        |
| <b>C</b> | <b>DALJET NE PARA GJITHSEJ</b>                 |   |   |   |   |   |   |   |   |   |        |
| 1        | Blerja e lëndëve të para/produkteve (variabël) |   |   |   |   |   |   |   |   |   |        |
| 2        | Qiraja e ndërtesës                             |   |   |   |   |   |   |   |   |   |        |
| 3        | Pagat neto të punonjësve                       |   |   |   |   |   |   |   |   |   |        |
| 4        | Sigurimet shoq + shëndetësore                  |   |   |   |   |   |   |   |   |   |        |
| 5        | Energjia elektrike                             |   |   |   |   |   |   |   |   |   |        |
| 6        | Uji +karburant                                 |   |   |   |   |   |   |   |   |   |        |
| 7        | Telefon +Internet                              |   |   |   |   |   |   |   |   |   |        |
| 8        | Materiale zyre /administrative                 |   |   |   |   |   |   |   |   |   |        |
| 9        | Reklama /Marketing                             |   |   |   |   |   |   |   |   |   |        |
| 10       | Kosto te veprimeve me bankën                   |   |   |   |   |   |   |   |   |   |        |
| 11       | Pagesa për mbajtjen e kontabilitetit           |   |   |   |   |   |   |   |   |   |        |
| 12       | Interesi                                       |   |   |   |   |   |   |   |   |   |        |
| 13       | Pagesat e kredisë                              |   |   |   |   |   |   |   |   |   |        |
| 14       | Pagesa pajisje me qira                         |   |   |   |   |   |   |   |   |   |        |

|           |                                             |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |
|-----------|---------------------------------------------|--|--|--|--|--|--|--|--|--|--|
| 15        | Pagesa për softëare                         |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |
| 16        | Siguracione makine                          |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |
| 17        | Taksat bashkie/akciza                       |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |
| 18        | Kosto te tjera                              |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |
| <b>D.</b> | <b>TEPRICA/ DEFICITI (B-C)</b>              |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |
| <b>E.</b> | <b>GJENDJA NE FUND TE PERIUDHES (A+B-C)</b> |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Turizimit, Bashkia Durrës.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

**KRYETAR**

**Denisa L. Marasi**



**U shpall sot me datë 11.02.2026**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**PREFEKTI I QARKUT Durrës**

Nr. 140 prot.

Durrës, më 16.02.2026

**Lënda:** Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK**  
**DURRËS**

**KRYETARIT TË BASHKISË**  
**DURRËS**

17.02.26 1680/6

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.09 datë 10.02.2026 ,” Për miratimin e ndryshimit të VKB nr.66, datë 11.11.2025, Për miratimin e udhëzuesit për mënyrën e aplikimit, “Për implementimin e skemës: Grante për të rinjtë në mbështetje të zhvillimit të iniciativave ekonomike lokale”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” i ndryshuar, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

**PREFEKTI**  
**ADRIAN GURRA**

